

ISLAMI

me pak fjalë

Mahmud Rida Murad



Mahmud R. Murad

ISLAMI
ME PAK FJALË

Prishtinë, 2001

Titulli në origjinal:
A Brief Look Upon Islam

Autor:
Mahmud R. Murad

Përktheu:
Arlind Boshnjaku

Përmbajtja

Parathënie	5
Kush është All-llahu ﷻ?	7
Ç'është Kur'ani Fisnik?	9
Vërtetësia e Kur'anit Fisnik	9
Kur'ani si mrekulli	10
Kur'ani si legjislacion gjithëpërfshirës	11
Shkenca dhe Kur'ani Fisnik	13
Krijimi i Qiejve dhe i Tokës	14
Riprodhimi njerëzor	16
Kush është Muhammedi ﷺ?	18
Ç'është Islami?	22
Shtyllat e Islamit	26
Kushtet e besimit	36
Rregullat e higjienës	43
Gruaja dhe familja në Islam	44
Rregullat e veshjes për gratë	45
Përfundim	47
Disa ajete nga Kur'ani për Islamin	48
Disa hadithe (thënie profetike) për Islamin	50
Profeci biblike për ardhjen e Muhammedit ﷺ	52

Formulat e përdorura në këtë libër:

Simboli	Përkthimi në shqip
	I Lartë qoftë All-llahu
	Paqja dhe shpëtimi i All-llahut qofshin mbi të

Parathënie

Kjo porosi është për çdo njeri të hapur dhe mendjegjerë. Është për çdo kërkuar të së vërtetës që ndoshta ndonjëherë ka pyetur veten se çfarë është feja islame, kush është Zoti (All-llahu), cili është qëllimi përfundimtar i ekzistencës së njeriut. Këto pyetje dhe shumë të tjera shtrohen për t'u shqyrtuar në raste të ndryshme, por më vonë ato prapësohen dhe lihen në mes për lloj-lloj arsye.

Islami është vërtet një fe e keqkuptuar dhe e paraqitur gabimisht në Perëndim. "Kjo nuk është edhe për t'u habitur, - deklaroi mjeku frëng Moris Bykaj, në fillim të librit të tij Bibla, Kur'ani dhe Shkenca,¹ – kur dimë se në çfarë mënyre sa e sa e gjenerata në Perëndim janë edukuar për t'i zgjidhur problemet religjioze dhe si janë mbajtur në padije për çkado që ka të bëjë me Islamin."

Për këtë arsye, idealet islame mbesin të paqarta për shumicën dërrmuese të jomuslimanëve.

Kjo broshurë nuk mëton të përgjigjet në të gjitha pyetjet për të cilat ju do të dëshironit përgjigje. Megjithatë, do të hapë për ju një dimension të ri të menduarit dhe do t'ju mundësojë që të kuptoni rëndësinë e rolit tuaj si njeri në këtë gjithësi dhe raportin ndërmjet juve dhe Krijuesit tuaj, Zotit, All-llahut të Plotfuqishëm. Paraqet Islamin me pak

¹ Originali i këtij libri është shkruar në frëngjishte, me titull *La Bible, le Coran et la Science* (Paris, 1976). Është përkthyer dhe është botuar edhe në gjuhën shqipe nga Nazim Juniku, me titull *Bibla, Kur'ani dhe Shkenca* (Gjakovë 1995)

fjalë dhe siguron përgjigje të thjeshta dhe të hapta në shumë pyetje për Islamin dhe besueshmërinë e tij.

Në këtë libërth ju do të mësoni për All-llahun e Madhërishtëm, për Shpalljen e Tij të fundit, për Profetin e Tij të fundit, për Islamin, për rolin e njeriut në këtë jetë, dhe për tema të tjera përkatëse.

Lexuesi duhet ta ketë të qartë se nuk ekziston ndonjë version i Kur'anit në gjuhën angleze (ose shqipe v.p.), por gjuha e vetme e Kur'anit është arabishtja. Ndonëse ajetet kur'anore dhe thëniet profetike të cituara në këtë broshurë janë dhënë me "All-llahu i Madhërishtëm thotë" ose "i Dërguari, paqja dhe mëshira e All-llahut qofshin mbi të, thotë", përkthimi i fjalëve të tyre në anglishte paraqet vetëm kuptimin e përgjithshëm të këtyre fjalëve.

Mahmud Rida Murad
Rexheb 1419
Nëntor 1998

Kush është All-llahu ﷻ?

All-llah është emri i saktë me të cilin quhet Zoti i Vërtetë, i Vetmi që ekziston, dhe ngërthen të gjithë Emrat e Tij të Shkëlqyeshëm Hyjnorë dhe Cilësitë e Tij të Përkryera. All-llahu ﷻ është Një dhe Unik. Ai nuk ka fëmijë, ortakë e askurrgjë të barabartë me të. Ai është Krijuesi dhe Mbajtësi i Vetëm i gjithësisë. Çdo krijesë dëshmon për Njëjësinë, natyrën e Tij hyjnore dhe Zotërimin e Tij (*Rububijeh*),² si dhe për Cilësitë dhe Emrat e Tij të pashoq. Qenësia e Tij nuk përqaset me asnjëfarë qenësie tjetër. Askurrkush nuk është si Ai. Ai është Një, i Vetmi dhe i Pandashmi. Ai është Zoti pa të Cilin asgjë nuk mund të arrihet, dhe të Cilit i gjithë Zotërimi i takon. Ai nuk lind dhe as nuk është i lindur. Ai nuk është pjesë e ndonjë gjëje dhe asgjë nuk jeton brenda Tij. Të gjitha krijesat kanë nevojë për Të, ndërsa Ai nuk është nevojtar për kurrgjë dhe për askënd.

All-llahu ﷻ është i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijshtëm. Dija e Tij përfshin në mënyrë të përsosur të gjitha gjërat, të fshehura ose të zbuluara. Por Ai është shumë më madhështor sesa që mund të kuptojnë me dijen e tyre krijesat e Tij. All-llahu ﷻ, më i Larti, është Zot i gjithçkasë, i Cili posedon liri për rregullimin e çdo çështjeje. Ai është i Mëshirshëm; Mëshira e Tij është e pakufishme dhe rrok çdokënd dhe çdo gjë. Padrejtësia dhe tirania kurrë nuk mund t'i përkasin Atij. Drejtësia e Tij siguron rregull në gjithësi, ku asgjë nuk thyen rregullin. Sundimin e Tij Ai nuk e ndan

² Për Zotërimin në arabishte thuhet *Rububijeh*. Rrjedh nga fjala *Rabb*, që do të thotë 'Zot' dhe nënkupton Krijuesin dhe Furnizuesin, Atë që dhuron jetën dhe shkakton vdekjen.

me askënd, dhe Ai nuk merr ndihmës e as përkrahës nga krijesat e Tij. Ai është Zoti i botëve. Ai është mbi shtatë qiejt, qëndron në Fronin e Tij (*Arsh*) në mënyrën që i përshatatet Madhësisë dhe Shkëlqesisë së Tij.

Ç'është Kur'ani Fisnik?

Kur'ani është të Folurit të All-llahut ﷻ. Nuk është gjë e krijuar. I është shpallur Muhammedit ﷺ nëpërmjet engjëllit Xhibril. Muhammedi ﷺ ajetet që i pranonte i fuste në kujtesë, i recitonte ato para shokëve që qëllonin pranë dhe u urdhëronte atyre t'i shkruanin ato menjëherë. Ndërsa nga një kopje të pjesëve të shpallura Muhammedi ﷺ e mbante në shtëpinë e vet. Kur'ani është Libri i fundit i All-llahut ﷻ, i cili ka zbritur pjesë-pjesë në një periudhë prej njëzet e tre vjetësh. Është i ndarë në 114 Kapituj (*Sure*) me gjatësi të ndryshme. Është prej burimeve fundamentale të mësimëve islame. Disa prej Kapitujve dhe ajeteve të tij janë shpallur në Mekë, gjersa të tjerat janë shpallur në Medinë. Kapitujt dhe ajetetet mekase shtjellojnë kryesisht çështjet themelore të besimit islam (*Akide*), siç janë monoteizmi, shenjat e ekzistencës së All-llahut ﷻ, jeta e Përtejvarrit dhe Dita e Ringjalljes. Theksi i veçantë në Njëjësinë e All-llahut ﷻ (*Teuhid*) ishte vatër e porosive që u dhanë gjithë profetëve të dërguar për njerëzimin, që nga Ademi e deri te Muhammedi ﷺ. Kapitujt që janë shpallur në Medinë merren me vepra adhurimi dhe me të gjitha aspektet e tjera të jetës.

Vërtetësia e Kur'anit Fisnik

Asnjë popull nuk është kujdesur, nuk ka nderuar dhe nuk e ka ruajtur Shkrimin e tij hyjnor më shumë sesa që muslimanët janë kujdesur, kanë nderuar dhe kanë ruajtur Kur'anin. Për dallim nga Shkrimet e tjera të shenjta që i kanë paraprirë atij, Kur'ani nuk mbahet në duart e ndonjë grupi a klani të posaçëm muslimanësh për të cilët ndokush do të

mund të dyshonte se bëjnë shtrembërime dhe ndryshime në të. Por, në fakt, atë mund ta posedojnë të gjithë muslimanët. Muslimanët janë të urdhëruar ta lexojnë atë në namazet e tyre ditore dhe t'i referohen atij për gjykim final në të gjitha polemikat dhe konfliktet e tyre. Kur'ani është përmbledhur në një vend në kohën kur ata që e kishin futur në kujtesë sa ishte gjallë i Dërguari ﷺ ishin ende duke jetuar. All-llahu ﷻ ka premtuar që ta ruajë atë. Dhe do të jetë kështu i mbrojtur deri në Ditën e Ringjalljes. Muslimanët sot lexojnë dhe recitojnë tekstet kur'anore që janë lexuar dhe recituar gjatë jetës së të Dërguarit Muhammed ﷺ dhe Shokëve të tij. As edhe një shkronjë nuk i është shtuar ose i është hequr. Pasi studioi Kur'anin, Dr. Moris Bykaj përfundoi:

“Falë vërtetësisë së tij të padiskutueshme, teksti i Kur'anit zë një vend të pashoq ndër Librat e Shpallur.”³

Kur'ani si mrekulli

All-llahu Lavdiplotë u bëri sfidë arabëve dhe joarabëve që të prodhojnë një Kur'an të ngjashëm me atë hyjnor. Sfida më vonë u zvogëlua në dhjetë Kapituj, dhe ata prapëseprapë dështuan në këtë. Përfundimisht, All-llahu ﷻ i sfidoi ata të prodhojnë vetëm një Kapitull që mund të përqaset me ndonjë Sure të Tijën. Ndonëse arabët asokohe ishin mjeshtër të gojëtarisë dhe poezisë, ata nuk mundën t'i bëjnë ballë kësaj sfide. Ata kuptuan se ai (Kur'ani) nuk mund

³ Dr. Moris Bykaj është një kirurg frëng që ka treguar interesim të veçantë për aspektet shkencore të Kur'anit. Ai mësoi arabishten dhe studioi Kur'anin në tekstin e tij origjinal. Ai mbeti i mahnitur me të dhënat e tij të përpikta shkencore. Si rrjedhojë, pas hulumtimeve të tij, Dr. Moris Bykaj pranoi Islamin.

të jetë nga askush tjetër përveçse nga All-llahu ﷻ, Zoti i botëve.

Dallimi ndërmjet mrekullive të Profetëve të përparshëm, që dëshmojnë për vërtetësinë e tyre, dhe mrekullive të të Dërguarit të All-llahut ﷺ, është se mrekullitë e tyre ishin efektive gjatë jetës së tyre, derisa mrekullia e tij e Kur'anit ka mbetur efektive dhe do të mbetë vepruese, e pasosur dhe e pakundërshtueshme gjer në Ditën e Gjykimit.

Kur'ani si legjislacion gjithëpërfshirës

Kur'ani përbën konceptin më gjithëpërfshirës të Islamit në nivelin praktik, si burim i Ligjit Hyjnor (*Sheri'ah*). Është gjithëpërfshirës, ngase ngërthen parime ligjore dhe morale, dhe besimin të cilin çdo musliman duhet ta pranojë. Sheriati islamik nuk është i përshtatshëm vetëm për muslimanët, por për tërë njerëzimin dhe për çdo kohë. Ligji islam drejton çdo vepër njezrëzore, duke përvijuar detyrat që ka secili person ndaj All-llahut ﷻ dhe njerëzve, qofshin ato publike a private.

Ligjet e formulara nga njerëzit mund të pësojnë ndryshime dhe janë të bazuara në teori. Sa herë që një trup i ri ligjvënësish merr kompetenca autoriteti, ose paraqitet një teori e re e pëlqyer tek ata, atëherë edhe ligjet ndërrohen në përputhje me këtë. Legjislacioni hyjnor, në anën tjetër, është i pandryshueshëm dhe i gjithmonshëm, sepse Ai që krijoi atë është i Pavdekshëm dhe i Përhjetshëm. Ai është Krijuesi që krijoi njerëzit dhe caktoi për ata atë që do t'u përgjigjej nevojave të tyre deri në fund të kohës. Mu për këtë shkak, Kur'ani, duke qenë Shpallje e fundit Profetit të fundit, zëvendëson të gjitha Shkrimet paraprijëse.

Shumë profeci të Kur'anit janë përmbushur plotësisht. All-llahu ﷻ u premtoi atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira se Ai me siguri do t'i bëjë ata ngadhënjimtarë në tokë. Ata sunduan në një territor të gjerë që përfshin shumë vende të botës. Kur'ani paratha se romakët do t'i mundin persët.⁴ All-llahu ﷻ thotë:

“Romakët u thyen. Në tokën e afërt, dhe pas humbjes ata do të jenë fitimtarë. Brenda tre deri nëntë vjetësh. Vendosja e çështjes, para dhe pas (këtyre ngjarjeve) është vetëm nga All-llahu. Dhe atë ditë besimtarët (muslimanët) do të gëzohen (nga fitorja që All-llahu u jep romakëve kundër persëve).” (30:2-4)

Personi që lexon Kur'anin objektivisht do të kuptojë se profecitë në të nuk kanë të bëjnë aspak me hamendje dhe spekulime. Ngase Ai që i zbuloi ato është Ai që i paracakttoi të gjitha ngjarjet deri në Ditën e Ringjalljes.

⁴ Këtë profeci e gjeni në Suren 30, të titulluar Er-Rum (Romakët). Ajo i referohet betejës ndërmjet persianëve dhe romakëve, që ndodhi në vitin 614, kur romakët pësuan disfatë. Tetë vjet më pas, romakët mundën persët, duke u përmbushur kështu plotësisht profecia e Kur'anit.

Shkenca dhe Kur'ani Fisnik

Muhammedi ﷺ ishte analfabet. Ai nuk dinte të shkruante e as të lexonte, dhe u rrit në Mekë, ku nuk kishte asnjë shkollë. Ai ishte tejte larg nga qarqet shkencore që ekzistonin në Siri, Aleksandri, Athinë ose Romë. Për më tepër, faktet shkencore të përmendura në Kur'an nuk qenë të njohura asokohe, d.m.th. në shekullin VII. Pasi studioi dhe ekzaminoi tekstin arab të Kur'anit, Dr. Moris Bykaj deklaroi:

“Unë nuk kam mundur të gjej as edhe një gabim në Kur'an. Kam qenë i detyruar të ndalem dhe ta pyesja veten: nëse njeriu është autor i Kur'anit, atëherë si mund të ketë shkruar në shekullin VII fakte që sot tregohen të jenë në pajtim me njohuritë moderne shkencore? U desha ta pranoja dëshminë që kisha pranë: Kur'ani nuk përmbante asnjë deklaratë që do të mund të përgënjeshtrohej nga këndvështrimi shkencor. E përsërita të njëjtën provë me Dhiatën e Vjetër dhe me Ungjijtë, gjithmonë duke mbajtur të njëjtin qëndrim objektiv. Në të parën nuk pata nevojë të kaloja përtej librit të parë, Gjeneza, që të gjeja deklaratat plotësisht në kundërshti me faktet e pamohueshme të shkencës bashkëkohore.”⁵

Dr. Bykaj ka studiuar shumë fakte shkencore të cekura në Kur'an, siç janë: krijimi i gjithësisë, astronomia, mbretëritë e kafshëve dhe të bimëve, riprodhimin njerëzor dhe çështje të tjera lidhur me to. Unë do t'i zgjedh, që të mos e

⁵ *Bibla, Kur'ani dhe Shkenca.*

zgjas, dy nga çështjet e sipërpërtreguara që t'ia tërheq vëmendjen lexuesit në një nga objektivat e kësaj broshure.

Krijimi i Qiejve dhe i Tokës

Njohuritë e njeriut për zanafillën e universit janë tejet të kufizuara. Shkencëtarët kanë propozuar hipoteza dhe teori të ndryshme të cilat vërtiten rreth një teme: lëmshi i zjarrtë fillestar dhe epoka e materies dhe e antimateries. Sipas këtyre teorive, gjithësia në fillim përbëhej kryesisht prej grimcave në ndërveprim të fuqishëm. Materia dhe kundërmateria fillestare, sipas *Encyclopaedia Britannica*, në fund asgjësuan njëra-tjetrën. Ato grimca që mbijetuan formuan githësinë që kemi sot.⁶ Procesi themelor i zhvillimit të gjithësisë është i paraqitur në Kur'an me fjalë të thjeshta. All-llahu ﷻ urdhëron të Dërguarin e Vet Muhammed ﷺ që t'i pyesë jobesimtarët:

“Thuaju (atyre): A vërtet nuk besoni tek Ai i Cili krijoi tokën në dy Ditë dhe a i vini Atij shokë duke adhuruar të tjerë në vend të Tij? Ai është Zoti i Botëve. Ai vendosi në të (në tokë) male të qëndrueshme nga lart saj; dhe Ai e bekoi atë dhe përcaktoi në të furnizimin e saj (për banorët e saj) me masë për katër Ditë të barabarta, (përgjigje kjo) për të gjithë ata që pyesin (për krijimin e saj). Pastaj Ai u ngrit lart drejt qiellit, kur ai ishte tym dhe i tha atij dhe tokës: “Ejani të dy ju me dëshirë a pa dëshirë.” Pastaj Ai plotësoi dhe përfundoi nga krijimi i tyre shtatë

⁶ *Encyclopaedia Britannica*, (Bot. i 15-të), *Macropaedia*, vëll. 18, f. 1008.

qiej në dy Ditë dhe Ai i vendosi secilit qiell punën e tij. Dhe Ne e stolisëm qiellin më të afërt me llamba (yje) për të qenë bukuri si edhe roja. Ky është vendimi i të Gjithëfuqishmit, i të Gjithëditurit.” (41:9-12)

Dhe All-llahu ﷻ thotë:

“A nuk e kanë ditur ata që mohojnë, se qiejt dhe toka ishin të bashkuar si një njësi e vetme krijimi, pastaj Ne i ndamë ata? Dhe Ne kemi bërë çdo gjë të gjallë, çdo lloj gjallese prej ujit.⁷ A nuk do të besojnë atëherë pra?” (21:30)

Ky koncept i ndarjes së një njësie në dy a më shumë pjesë, dhe “tymi” qiellor i sipërpërmendur, është në pajtim me të dhënat faktike shkencore. Ja se çfarë thotë në Encyclopaedia Britannica, fizikani dhe astronomi anglez Sir Xheims Xhins:

“Ne kemi mësuar se, ashtu si supozoi në fillim Njutni, një masë kaotike gazi me dendësi përafërsisht uniforme dhe me përmasa jashtëzakonisht të mëdha, do të kishte pasur dinamikë jostabile: në të do të formoheshin bërthama, dhe përreth e tërë materia përfundimisht do të kondensohej. Në bazë të kësaj teo-

⁷ Disa e kanë keqinterpretuar këtë ajet duke mbështetur me të teorinë darviniane të evolucionit. Kuptimi i këtij ajeti është se All-llahu ﷻ vendosi ta zhvillojë gjithësinë në formën që është sot duke bërë që uji të jetë elementi kryesor i çdo qenieje të gjallë.

rie ai propozoi se të gjithë trupat qiellorë kanë zana-
fillën nga procesi i fragmentimit...”⁸

E dimë fare mirë se programet kozmike kanë zbuluar se
substancia nga e cila janë të përbëra Hëna, Toka dhe pla-
netët e tjerë është homogjene. “Deklarata të tilla në Kur’an
që flasin rreth krijimit, të vjetra afro katërmëdhjetë she-
kuj, - përfundon Dr. Bykaj, - qartazi nuk mund të kenë
shpjegim njerëzor.”⁹

Riprodhimi njerëzor

Hollësitë e ndërlikuara të riprodhimit njerëzor janë deshif-
ruar dhe janë kuptuar vetëm pas zbulimit të instrumenteve
më komplekse shkencore dhe mjekësore, qindra vjet pas
vdekjes së Muhammedit ﷺ, dhe megjithëkëtë në Kur’an
përmenden fazat nëpër të cilat kalon embrioni i njeriut.
All-llahu ﷻ thotë:

“Dhe sigurisht që Ne e krijuam njeriun nga
një copë baltë (ujë me dhe). Pas kësaj Ne e
bëmë atë si *Nutfah* (lëngu i ngjizur i bash-
kimit të qelizave seksuale mashkullore dhe
femërore) duke e strehuar atë në një banesë
të sigurt (mitra e nënës). Pastaj Ne e bëmë
Nutfan në një copë gjaku të mpiksur, pastaj
Ne e bëmë gjakun e mpiksur në një xhungë
mishi, pas kësaj Ne bëmë prej xhunge mishi
eshtrat, pastaj i veshëm eshtrat me mish dhe
pastaj Ne e nxorëm jashtë si një krijim të ri.

⁸ *Encyclopaedia Britannica* (Bot. i 15-të), *Macropaedia*, vëll. 18, f.1009.

⁹ *Bibla, Kur,ani dhe Shkenca*.

I Shenjtëruar pra qoftë All-llahu, më i Miri i krijuesve.” (23:12-14)

Nga provat e vërtetuara shkencore, fazat e riprodhimit njerëzor janë:

1. Fekondimi i vezës bëhet në tubat e Fallopit. Agjenti pllenues është sperma e mashkullit.
2. Mbjellja (ngulitja) e vezës se pllenuar ndodh në vend të caktuar në sistemin riprodhues femëror. Ajo zbret në mitër dhe fiksohet në trup të mitrës. Në çastin kur embrioni mund të shihet nga syri i lirë, ai duket si një masë e vogël mishi. Aty ai zhvillohet në faza progresive të cilat sot njihen shumë mirë. Ato janë formimi i strukturës eshtrore, i muskujve, i sistemit nervor, i qarkullimit të gjakut, dhe i organeve të brendshme, etj.¹⁰

Në fund, Dr. Bykaj vërteton:

“Më shumë se një mijë vjet para kohës sonë, në një periudhë kur doktrinat tekanjoze ende mbretëronin, njerëzit dinin për Kur'anin. Deklaratat që ai përmban shprehin në terma të thjeshtë të vërteta të rëndësishme elementare, për të cilat njeriut i është dashur shekuj për t'i zbuluar.”¹¹

¹⁰ *Macropaedia*, vëll. 18, f. 1008

¹¹ *Bucaille*.

Kush është Muhammedi ﷺ?

**“Dhe Ne nuk të kemi dërguar (O Muham-med) veçse si mëshirë për gjithë botët.”
(21:107)**

Muhammedi ﷺ është i fundit nga të Dërguarit dhe Profetët. Emri i tij është Muhammed biri i Abdullahut. Ai ka lindur në Mekë në vitin 570. Në rininë e tij, i Dërguari Muhammed ﷺ ishte një kombinim i përkryer i cilësive më të mira shoqërore. Ishte njeri shembullor me mendje të matur dhe gjykim të pagabueshëm. Shquhej për intelegjencë, për origjinalitet të mendimit dhe për zgjedhje të duhur të mjeteve deri te caqet korrekte. Heshtja e tij e gjatë i ndihmonte atij për të përsiatur dhe për të hulumtuar më thellë të vërtetën. Mendja e tij e ndriçuar dhe natyra e tij e çiltër kishin rol të rëndësishëm në përvetësimin dhe në kuptimin e rrugëve të jetës, si dhe për t'i kuptuar individët, grupet dhe komunitetet. Ai u shmangej praktikave bestytnore, por merrte pjesë aktivisht në veprimtari të dobishme dhe konstruktive. Ai nuk u afrohej pijeve dehëse, nuk hante mish kafshe të therorizuar në altare guri dhe nuk u bashkohej idhujtarëve nëpër festivalet e tyre.

Ai dëshmoi se ishte burrë ideal, me karakter të panjollorur. Ai ishte më i mirësjellshmi ndër bashkatdhetarët e vet, më i ndershmi kur fliste dhe me zemërbuti nga të gjithë. Ishte më fisniku, më i çiltri dhe më mikpritësi, dhe gjithnjë linte mbresa të thella te njerëzit me fytyrën dhe pamjen e tij të devotshme. Ishte më besniku dhe më i miri në mbajtjen e marrëveshjeve. Për shkak të namit të mirë që gëzonte te njerëzit, e quajtën ‘I Besueshmi.’

Kjo mbresë te njerëzit rridhte nga lumturia që kaplonte zemrat e tyre dhe i mbushte me dinjitet. Nderi, respekti i thellë dhe vlerësimi i lartë që njerëzit tregonin ndaj të Dërguarit të All-llahut ﷺ ishin të pashoq. Kurrë ndonjë njeri nuk është nderuar dhe nuk është dashur më shumë se ai. Ata që e njihnin mirë ishin të mahnitur dhe të magjepsur prej tij. Ata ishin të gatshëm për të flijuar jetën e tyre vetëm për të shpëtuar një thua të tijin nga lëndimi. Ai posedonte aspekte të përsosurisë të cilat nuk i janë dhuruar askujt tjetër, ndaj Shokët e tij e konsideronin unik dhe e donin pa masë.

Kur u ngarkua si Profet, në moshën katërdhjetë vjeçe, All-llahu ﷻ i shpalli atij ajetet e para kur'anore nëpërmjet engjëllit Xhibril. Ai urdhëroi të Dërguarin ﷺ të thërrasë në Njëjësinë e All-llahut ﷻ dhe t'i paralajmërojë njerëzit kundër politeizmit.

Politeistët mekas u bënë kundërshtarë të tij dhe filluan t'i përndjekin ashpër pasuesit e tij, mirëpo kjo nuk lëkundi besimin e tij dhe nuk tundi këmbëngulësinë dhe durimin e tij. As nuk mundi t'i pengonte njerëzit për t'iu përgjigjur thirrjes së tij. Përfundimisht, kur shumica e banorëve të Medinës përqaftuan Islamin, muslimanët e Mekës u shpërngulën dhe gjetën strehim në Medinë. Më vonë, edhe vetë i Dërguari i All-llahut ﷺ vajti në Medinë për të themeluar shtetin islam aty. Disa vjet më pas, politeistët mekas dhe aleatët e tyre mbetën të gjunjëzuar para fuqisë në rritje të muslimanëve, dhe Meka u pushtua pa dhunë. Rreth tri-dhjetë vjet pas vdekjes së Profetit Muhammed ﷺ, Islami u përhap nëpër tërë botën, duke mposhtur dy perandoritë më të mëdha atëbotë, Perandorinë Persiane dhe Romaken.

Shumë dijetarë dhe personalitete me zë të Perëndimit kanë pranuar se asnjë e metë ose gabim nuk mund të vihet re në karakterin dhe sjelljen e të Dërguarit ﷺ. Disa nga deklaratat e tyre janë të jashtëzakonshme. Xhorxh Bernard Shoka shkruar:

“Besoj se sikur udhëheqjen e botës moderne do të merrte një njeri si ai, do të kishte qenë i suksesshëm në zgjidhjen e problemeve duke sjellë paqen dhe lumturinë e kërkuar shumë. Evropa ka filluar të magjepset me besimin e Muhammedit. Në shekullin e ardhshëm ajo do të mund të shkonte më tutje duke pranuar dobinë e atij besimi në zgjidhjen e problemeve të saj.”¹²

Lamartini ka lavdëruar të Dërguarin ﷺ duke thënë:

“Nëse madhështia e qëllimit, mjetet e pakta dhe rezultatet e habitshme janë tri kritere të gjeniut njerëzor, kush mund të përqasë ndonjë njeri të madh të historisë moderne me Muhammedin?”¹³

Prijësi indian, Mahatma Gandhi ka shkruar për të Dërguarin ﷺ:

“Po bindem më shumë se kurrë më parë se nuk qe shpata që siguroi fitore për Islamin asokohe. Por qe thjeshtësia e paepur, modestia e plotë e të Dërguarit, kujdesi i përpiktë ndaj zotimeve të bëra, përkushtimi i thellë ndaj shokëve dhe pasuesve të tij, si dhe tri-

¹² Një përmbledhje shkrimesh nga disa dijetarë eminentë, 1935.

¹³ *Histoire de la Turquie*, 1855.

mëria, papërkulshmëria dhe besimi absolut në Zotin dhe në misionin e tij. Këto e jo shpata sollën suksesin e shënuar dhe thyen çdo pengesë.”¹⁴

Ç'është Islami?

Islami është feja e fundit hyjnore. Emri i tij është ligjësuar nga Kur'ani, gjatë Haxhit Lamtumirës:

“Këtë ditë Unë përsosa fenë tuaj për ju, plotësova Mirësinë Time mbi ju dhe zgjodha për ju Islamin si fe.” (5:3)

Islami është e fundit nga fetë universale. Sot numëron mbi 1.25 miliard ndjekës. Secili shtet në botë ka të paktën një minoritet të vogël muslimanësh. Islami është treguar jo vetëm si feja më e përhapur në botë, por edhe si më dinamika, duke tërhequr muslimanë të rinj me shpejtësi më të madhe se kurdoherë në shekujt e fundit.

Shprehja arabe *Islam*, që do të thotë *dorëzim, nënshtrim*, tregon për besimin religjioz fundamental të muslimanit, e i cili është nënshtrim vullnetit të All-llahut ﷻ duke iu dorëzuar së brendshmi dhe së jashtmi ligjit të Tij. Islami nuk është ‘religjion’ në kuptimin e ngushtë të fjalës të përdorur nga humanistët shekullarë në Perëndim, por është feja e përjetshme dhe universale që nëpërmjet Profetëve i është zbuluar çdo kombi a populli që prej fillimit të racës njerëzore. Feja islame vë theks të veçantë në monoteizëm të paepur dhe në përkushtimin e rreptë ndaj besimit dhe mënyrës së tij të adhurimit. Ajo urdhëron njeriun t’i nënshtrohet fuqishëm vullnetit të All-llahut ﷻ dhe nxit çdo person të pasojë sa më tepër rrugën shembullore të jetës së Muhammedit ﷺ, të Dërguarit të fundit.

All-llahu ﷻ krijoi gjithësinë dhe gjithçka në të që Ai të njihet dhe të pranohet si Zot i Vetëm dhe i Pakundshoq. Ai krijoi njerëzit dhe xhinnët vetëm për ta lavdëruar, për ta përnderuar dhe për ta adhuruar Atë. All-llahu ﷻ thotë:

**“Dhe Unë nuk i krijova njerëzit dhe xhinnët
veçse që të më adhurojnë vetëm Mua.”**
(51:56)

Mënyra dhe forma e adhurimit nuk i janë lënë tekave dhe zgjedhjes së njeriut. All-llahu ﷻ është Ai që cakton dhe urdhëron të gjitha veprat e adhurimit dhe mënyrën e kryerjes së tyre. Duke qenë se Islami merret me çdo aspekt: shpirtëror dhe trupor, jurisprudenca e tij bazohet në besim, udhëzim, adhurim dhe në dispozita që trajtojnë problemet sociale, ekonomike dhe politike.

Meqë Islami është mënyrë e përsosur e jetës, ai urdhëron të mbahen norma të larta morali dhe karakteri. I Dërguari i All-llahut ﷺ ka thënë:

**“Vërtet, unë jam dërguar që të përkryej sjelljen
(moralin).”**

All-llahu ﷻ ka lëvdur sjelljen shembullore të të Dërguarit të Tij ﷺ, duke thënë:

**“Dhe vërtet ti je në një shkallë të lartë ka-
rakteri.” (68:4)**

Aishja, All-llahu qoftë i kënaqur me të, gruaja e të Dërguarit të All-llahut ﷺ, ishte pyetur për sjelljen e tij. Ajo tha:

Aishja, All-llahu qoftë i kënaqur me të, ka dashur të thotë se i Dërguari ﷺ i është përmbajtur rreptësisht Kur’anit, rregullave të tij të disiplinës, urdhëresave dhe ndalesave dhe të gjitha mësimave të tij të shkëlqyeshme, të bukura dhe madhështore. Mu për këtë arsye, All-llahu ﷻ urdhëron besimtarët që të pasojnë jetën shembullore të të Dërguarit të Tij ﷺ:

“Pa dyshim që tek i Dërguari i All-llahut keni një shembull të shkëlqyeshëm...”
(33:21)

Islami nxit që karakteri i mirë të shprehet me sjellje të mirë në çdo rast: gjatë përshëndetjes, uljes, ngrënies, mësimit, ligjërimit, argëtimit, udhëtimit, veshjes, vizitës, fjetjes, gjatë kontakteve me njerëz, sidomos me kushërinj dhe fqinjë, etj. Kodet për të gjitha aspektet e tilla të sjelljes së përkryer i gjejmë si në Kur’an, ashtu edhe në thëniet e të Dërguarit të All-llahut ﷺ.

Familja gëzon status të lartë në Islam. Ajo është thelbi i shoqërisë, ngase familja e shëndoshë siguron shoqëri të shëndoshë. Për këtë shkak All-llahu urdhëron që prindërit të trajtohen me zemërbutësi dhe përrulje, duke thënë:

“Ndërsa Zoti yt ka përcaktuar që ti të mos adhurosh askënd e asgjë veç Atij dhe që të jesh i përkushtuar ndaj prindërve të tu. Në qoftë se njëri prej tyre ose të dy arrijnë moshën e pleqërisë dhe ti je gjallë me ta, mos u thuaj atyre ‘uf’, e as mos u bë i

vrazhdë ndaj tyre, por t'u drejtoheni atyre me shprehje nderuese e me respekt. Dhe ule mbi ta krahun e nënshtrimit, të mirësisë e të përuljes me mëshirë dhe thoni: 'Zoti im! Dhuroju mëshirën Tënde, pasi ata më rritën mua kur unë isha i mitur.'" (17:23,24)

Menjëherë pas familjes vjen farefisi. I Dërguari i All-llahut ka thënë se All-llahu ka premtuar se do të jetë i butë me personin që trajton kushërinjtë e tij me butësi, dhe do ta largojë nga Mëshira e Vet personin që rëndon lidhjet me farefisën e tij.

Shkallët e besimit

Umeri, All-llahu qoftë i kënaqur me të, tregon:

Një ditë derisa po rrinim me të Dërguarin e All-llahut ﷺ, na u afrua një njeri me rroba tejte të bardha dhe me flokë shumë të zinj. Nuk kishte asnjë shenjë udhëtimi në të, dhe asnjëri nga ne nuk e njihte. Ai [erdhi dhe] u ul pranë të Dërguarit ﷺ. I mbështeti gjunjët në gjunjët e të Dërguarit ﷺ dhe i vendosi duart e vet në kofshët e tij. Ai tha: “O Muhammed, më trego për Islamin.” I Dërguari i All-llahut ﷺ tha: “Islami është të dëshmosh se nuk meriton askush të adhurohet pos All-llahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i All-llahut, të falësh namazin, të japësh zekatin, të agjërosh Ramazanin, dhe të kryesh Haxhin në Shtëpi (Qabe) nëse ke mundësi.” Ai tha: “E ke thënë të vërtetën.” [Umeri tha:] Ndërsa ne u çuditëm se si është duke e pyetur dhe duke ia vërtetuar fjalët. Ai tha: “Më trego për Imanin (besimin).” Ai [i Dërguari i All-llahut ﷺ] u përgjigj: “Është të besosh në All-llahun, në engjëjt e Tij, në librat e Tij, në të Dërguarit e Tij, në Ditën e Fundit dhe të besosh në kader-paracaktim, në të keqen dhe në të mirën e tij.” Ai tha: “E ke thënë të vërtetën.” Ai tha: “Më trego për Ihsanin (mirësinë).” Ai tha: “Është ta adhurosh All-llahun sikur je duke e parë Atë, ndonëse ti nuk e sheh Atë, Ai të sheh ty.” “Më trego për Çastin e Fundit.” Ai [i Dërguarit ﷺ] u përgjigj: “I pyeturi

nuk di më shumë se pyetësi.” Ai tha: “Më trego për shenjat e tij.” Ai u përgjigj: “Kur robëresha të lindë zotëriun e saj; dhe t’i shihni barinjtë këmbëzbathur, me rroba të grisura duke bërë gara në ndërtimin e pallateve të larta.” Pastaj ai u largua. Unë qëndrova për një kohë të gjatë. Atëherë ai [i Dërguari] tha: “O Umer, a e di se kush është pyetësi?” Unë thashë: “All-llahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri.” Ai tha: “Është Xhibrili, erdhi t’jua mësojë fenë juve.””
(Buhariu dhe Muslimi)

I Dërguari i All-llahut ﷺ ka thënë se Islami është ndërtuar në pesë shtylla:

1. Dëshmia e Besimit (*Shehadah*)
2. Namazi (*Salat*)
3. Lëmosha e detyrueshme (*Zekat*)
4. Agjërimi (*Saum*)
5. Pelegrinazhi (*Haxh*)

Dëshmia e Besimit (*Shehadah*)

Dëshmia e Besimit, *Shehadah* në arabishte, duhet të deklarohej nga secili që pranon Islamin. Ajo është: “*La ilahe il-lallah, Muhammedur-Resulull-llah,*” që do të thotë “Nuk ka Zot të vërtetë pos All-llahut, dhe Muhammedi është i Dërguari i All-llahut.” Kuptimi i saj është se nuk meriton asgjë dhe askush të adhurohet përveç All-llahut ﷻ, dhe se Ai duhet të adhurohet vetëm në përputhje me mësimet e të Dërguarit të Tij Muhammed ﷺ.

Namazi (*Salat*)

Fjala arabe *Salat* gjuhësisht do të thotë lutje, por si ritual namazi është një tërësi veprimesh të rregullta fizike me recitim të ajeteve nga Kur'ani dhe të lutjeve të caktuara.

Ai është mjet komunikimi ndërmjet njeriut dhe All-llahut ﷻ, Zotit të tij (*Rabb*). Në të, njeriu demonstroi dorëzimin dhe dashurinë ndaj All-llahut ﷻ. Është shtylla më e rëndësishme pas Dëshmisë së Besimit dhe strumbullar i Islamit. Është vepër adhurimi që kombinon pozicionet e qëndrimit në këmbë, të përkuljes, të vendosjes së fytyrës në tokë, dhe të uljes, me thënien e Tekbireve (*All-llahu ekber* – All-llahu është më i madhi!), të Teslimit (*Es-selamu alejkum ve rahmetull-llahi ve berekatuhu* – Paqja, mëshira dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi ju!).

Namazi konsiderohet dritë e besimtarit, mbrojtje kundër mëkatimit dhe mjet për shlyerje të gjynaheve të mëparshme.

Rëndësia e namazit

Namazi, *Salat*, është i detyrueshëm për çdo musliman të pjekur, ndërsa fëmijëve ai duhet t'u mësohet në moshën shtatë vjeçe. Është mirë të inkurajohen ta falin atë në moshën më të re, ndërsa me të mbushur dhjetë vjet duhet të urdhërohen për ta falur atë.

Vonimi i namazit pas kohës së përcaktuar, pa ndonjë arsye të vlefshme a legjitime, është i ndaluar. I Dërguari ﷺ ka thënë:

“Secili musliman që kryen një namaz të detyrueshëm pasi të ketë bërë abdes (pastrimin ritual të larjes së pjesëve të caktuara të trupit), dhe plotëson përkuljet dhe sexhdet e tij (uljen e fytyrës në tokë), do t’i ketë të falura mëkatet e kaluara, përderisa të përmbahet nga kryerja e mëkateve të mëdha. Kjo vlen përgjatë tërë jetës.”

Të mohohet namazi si vepër obligative adhurimi, paraqet braktisje të Islamit, derisa mospërfillja e tij është akt pabesie. Namazi është caktuar si vepër e detyrueshme atëherë kur i Dërguari ﷺ u mor në qiellin e shtatë, në një udhëtim të mrekullishëm.

Do të jetë gjëja e parë për çka do të pyetet njeriu në Ditën e Ringjalljes.

Ai duhet të kryhet në kohë të caktuar pesë herë në ditë. Këto pesë namaze ditore janë:

1. Namazi i mëngjesit (*Salat-ul-Fexhr*): Përbëhet prej dy njësive të detyrueshme, (*Rek’at*). Këtyre i paraprijnë dy njësi vullnetare (*Sunnah*). Koha e këtij namazi nis nga agimi e deri në lindje të diellit.
2. Namazi i mesditës (*Salat-ul-Dhuhr*): Është katër njësisish. I paraprijnë katër njësi vullnetare (dy nga dy) dhe pas vijnë dy njësi të tjera vullnetare. Ky falet pasi të ketë kaluar dielli zenitin e deri në gjysmën e dytë të pasditës.
3. Namazi i pasditës (*Salat-ul-‘Asr*): Ky namaz ka katër njësi obligative dhe kryhet kur gjatësia e hijes së një shkopi vertikal të jetë e barabartë me gjatësinë

e vetë shkopit. Koha e faljes së tij vazhdon deri pak para perëndimit të diellit. Kush dëshiron mund t'i falë katër rekate para njërive obligative.

4. Namazi i mbrëmjes (*Salat-ul-Magrib*): Është i përbërë nga tri njësi të detyrueshme, që ndiqen me dy të tjera vullnetare. Falet menjëherë pas perëndimit të diellit dhe koha e tij mbaron me të përfunduar muzgu.
5. Namazi i natës (*Salat-ul-'Isha*): Ky është namazi i fundit ditor, i cili përfshin katër njësi obligative. Para dhe pas tij mund të falen nga dy rekate vullnetare, dhe pas këtyre edhe tri ose një njësi vullnetare (*Vitr*). Koha e tij fillon kur të ngryset plotësisht dhe zgjat deri në agim, ndonëse është më mirë të falet para mesnate.

Namazet e detyrueshme mund të falen vetëm, ose më e pëlqyeshme është që të kryhen në grup të cilit i prin imami (udhëheqësi i namazit). Thirrja në namaz (*Ezani*) bëhet në fillim të kohës së çdo namazi.

Që të falet namazi, duhet qenë në gjendje të pastërtisë rituale, gjë që arrihet me marrje të abdesit. Abdesi përfshin larjen e duarve, shpërlarjen e hundës dhe të gojës, larjen e fytyrës dhe parakrahëve, fërkimin e kokës me duar të lagura dhe larjen e shputave.

Namazi është prej shtyllave më madhështore të Islamit. Është vepra e parë e adhurimit për të cilën njeriu do të japë llogari në Ditën e Gjykimit. Nëse All-llahu ﷻ i pranon

namazet ndokujt, atëherë Ai do t'i pranojë edhe veprat e tjera të mira të tijat.¹⁵

Lëmosha e detyrueshme (Zekat)

Zekati, që është përafërsisht ekuivalent me taksën e vjetër që jepej për të varfrit në Angli, është shtylla e tretë e Islamit. Ky institucion financiar është i bazuar në njohjen e faktit se All-llahu ﷻ është Zotërues i gjithçkasë. Prandaj Ai ka të drejtë të caktojë ligjet e pronësisë, mjetet e fitimit të pasurisë dhe mënyrat e shpenzimit të tij. Zekati pikë-sëpari nënkupton, dëllirje, shtim, rritje, dhe ky është ende qëllimi i dhënies së tij.

Ai paguhet për disa lloje të caktuara të pronës, dhe u jepet klasave të posaçme të muslimanëve të varfër, siç ceket në udhëzimet vijuese të Kur'anit:

“Lëmoshat (këtu me kuptimin Zekat) janë vetëm për fukaratë (të varfër që nuk kërkojnë) dhe të vobektit (që lypin), për ata që janë punësuar për mbledhjen e tij (Zekatit), për të tërhequr zemrat e atyre që janë të prirur drejt Islamit, për të liruar robërit, për ata që janë në borxhe, për Çështjen e All-llahut, për rrugëtarin (e mbetur në mes të katër udhëve ose endacakun): një detyrim i ngarkuar nga All-llahu. Dhe All-llahu është i Gjithëditur, më i Urti Gjithëgjykues.” (9:60)

¹⁵ Secili individ do të mbahet përgjegjës për çfarëdo çështje edhe më të vogël, dhe në Ditën e Llogarisë ai do të dalë fare vetëm për t'u pyetur nga All-llahu ﷻ. Çdokush është përgjegjës për veprat e veta. Jeta e secilit në Përjetësi do të jetë ose lumturi e pasosur, ose vuajtje e përjetshme.

Zekati e pastron dhënësin e tij nga koprracia dhe makutëria. Po kështu, ai paraqet një sistem të mirëqenies shoqërore që kultivon dashuri vëllazërore, miqësi dhe bashkëpunim ndërmjet muslimanësh. Dhe mbush boshllëkun mes të pasurve dhe skamnorëve në baza të mëshirës dhe butësisë. Për këtë All-llahu shpërblen tej mase. I Dërguari ka thënë:

“Ai që paguan zekatin, largon të keqen e mallit të vet.”

Zekati paguhet për pronat e të gjithë muslimanëve, qofshin të vjetër a të rinj, meshkuj a femra, të shëndoshë mendërisht a të marrë. Duhet të paguhet për këto pasuri:

1. Flori, argjend dhe të holla
2. Bagëti
3. Prodhime bujqësore
4. Fruta-perime dhe mallra komerciale
5. Thesare dhe miniera

Po qe se një person vdes para se të paguajë zekatin e duhur për pasurinë e vet, atëherë ai duhet të merret nga prona e të ndjerit para se t'u ndahet trashëgimtarëve.

Të mohohet zekati a cilado shtyllë tjetër e Islamit është femohim. All-llahu i Plotfuqishëm ka premtuar se do t'i dënojë ashpër ata që nuk e japin zekatin.

Agjërimi (*Saum*)

Agjërimi i muajit Ramazan është shtylla e katërt e Islamit, të cilën All-llahu e bëri detyrim në vitin e dytë të Hixhrës.¹⁶ Agjërimi i Ramazanit është i detyrueshëm për çdo musliman të pjekur, me mendje të shëndoshë. Ai përfshin largimin nga ushqimi dhe pija si të shkrepë agimi e deri në perëndim të diellit. Agjërimi ndihmon për të zhvilluar durimin, tolerancën, vetëpërmbajtjen dhe frikën ndaj All-llahut ﷻ. Ai gjithashtu ndihmon që njeriu të tregojë dhembshuri më të madhe për muslimanët e varfër dhe rrit shpërblimin e lëmoshës. Gjatë muajit të Ramazanit, portat e Parajsës janë të hapura, ndërkaq ato të Ferrit janë të mbyllura. Në Ramazan, është një natë që nëse kalohet në lutje, sjell shpërblim më të madh se një mijë muaj adhurimi.

Agjërimi fillon kur të shihet hëna e re e muajit të Ramazanit dhe mbaron me hënën e re të muajit vijues, Shevval. Fundi i tij shënohet me Fitr-Bajramin (*'Id-ul-Fitr*). Nëse ndokush nuk ka agjëruar një a më shumë ditë në Ramazan për arsye të ligjshme, duhet t'i kompensojë këto pas Ramazanit.

Gjërat që prishin agjërimin janë:

- Ngrënia, pirja ose kontakti seksual i qëllimshëm gjatë kohës së agjërit
- Gjakrrjedhja e menstruacioneve ose e lehonisë
- Vjellja e qëllimshme
- Nxjerrja e gjakut (dhënia e gjakut)

¹⁶ Viti kur i Dërguari ﷺ u shpërngul në Medinë.

Në qoftë se të gjitha këto bëhen nga harresa, atëherë nuk vjen gjer te prishja e agjërimit.

Pelegrinazhi (Haxh)

Haxhxi ose Pelegrinazhi është shtylla e pestë e Islamit. Që përfshin kryerjen e disa ritualeve të caktuara gjatë muajit hënor Dhul-Hixhjes, në Mekë dhe në disa vende të afërta me të. Haxhxi është i detyrueshëm një herë në jetë për çdo musliman të pjekur dhe me mendje të shëndoshë, që nga ana fizike dhe financiare është i aftë për ta kryer atë. I Dërguari i All-llahut ﷺ ka thënë:

“Ai që kryen Haxhxin pa e prishur atë me ndonjë akt seksual a vepër mosdëgjese, do të kthehet në shtëpi i pastër nga mëkatet sikur ditën që ka lindur.”

Si çdo vepër tjetër adhurimi, edhe kryerjes së Haxhxit duhet t'i paraprijë qëllimi (nijeti) për ta bërë atë. Gjithashtu, për të qenë korrekt, haxhiu duhet të veshë pëlhurën e devocionit, ose ihramin.¹⁷ Në të vërtetë, veshja e një cohe të tillë është formë konkrete për të shprehur qëllimin për

¹⁷ Ihrami paraqet hyrjen në gjendjen kur haxhiu bën nijet të kryejë haxhxin ose umrën (haxhxin e vogël). Për mashkullin kjo do të thotë të mbështjellë me një copë pëlhurë pjesën e trupit nga sipër kërthizës e deri nën gjunjë. Pjesa tjetër mbështillet rreth pjesës së sipërme të trupit, pa kokën. Është e ndaluar për të të veshë rroba të qepura, çorapë ose këpucë. Si mbathje lejohen pantoflat ose të ngjashme me to. Gjithashtu, të ndaluara janë të gjitha aktivitetet seksuale, gjuetia dhe të ngjashme. Në kushte normale, kur një musliman ka hyrë në këtë gjendje devocioni ose në ihram, ai do të duhej të qëndronte në këtë gjendje derisa të plotësonte të gjitha ritet e haxhxit a umrës. Mirëpo, nëse ndokush nuk mund të plotësojë haxhxin ose umrën për shkaqe shëndeti, ose të frikës nga armiku a nga ndonjë rrezik i madh, ai mund të ndërpresë pelegrinazhin dhe të flijojë si kompensim një dele, dash a deve.

bërjen e haxhxit ose umrës, haxhxit të vogël.¹⁸ Sapo të hyjë në këtë gjendje devocioni dhe të veshë ihramin, që përbëhet nga dy copa pëlhure me të cilat mbështillet pjesa e sipërme e trupit nga kërthiza e poshtë, për haxhiun derisa të përfundojë gjendja e ihramit me mbarimin e haxhxit ose umrës, bëhen të ndaluara këto gjëra:

1. Prerja ose ndukja e qimeve prej çfarëdo pjese të trupit,
2. Prerja e thonjve të dorës a të këmbës,
3. Vënia e kapelës a e çfarëdo mbulese për kokë,
4. Parfumosja,
5. Kontakti seksual,
6. Të konsumohet martesë.

Haxhxi fillon me shtatë xhiro rreth Qabes dhe vazhdon me kalimin e largësisë shtatë herë ndërmjet kodrinave Safa dhe Merva. Në ditën e tetë të muajit Dhul-Hixhxe, haxhilerët shkojnë në Mina, mëpastaj në Arafat, dhe pastaj në Muzdelife, dhe më pas kthehen në Mina për t'i kryer disa rituale të caktuara dhe e përfundojnë me flijimin e një kafshe: një deleje, dashi, lope a deveje.

¹⁸ Umra, ose haxhxi i vogël, siç quhet shpesh, është vizitë Mekës në një kohë çfarëdo brenda vitit. Rituale të tij zhvillohen tërësisht brenda kufijve të Xhamisë së Shenjtë në Mekë. Umra është zakonisht pjesë e haxhxit. Ai përfshin shtatë rrotullime rreth Qabes, faljen e dy rekateve, pastaj pihet ujë Zemzemi dhe përfundimisht kalohet shtatë herë largësia mes dy kodrinave Safa dhe Merva.

Kushtet e besimit

Janë gjashtë kushte të besimit:

1. Besimi tek All-llahu ﷻ,
2. Besimi në engjëjt e Tij,
3. Besimi në Librat e Tij,
4. Besimi në të Dërguarit e Tij,
5. Besimi në Ditën e Fundit, dhe
6. Besimi në Paracaktimin Hyjnor (*Kada' dhe Kader*).

Besimi tek All-llahu ﷻ

Kjo nënkupton që All-llahu ﷻ të besohet si i Vetmi Zot, të Cilit i gjithë adhurimi i takon, se Ai është Krijuesi dhe Mbajtësi i gjithçkasë, se është Ai që jep dhe shkakton vdekje, dhe se Ai është i pakundshoq në Emrat dhe Atributet e Tij.

Besimi në engjëjt e Tij

All-llahu ﷻ ka krijuar engjëjt nga drita. Ata janë robër të ndershëm të All-llahut ﷻ, që i nënshtrohen Atij dhe ekzekutojnë urdhrat e Tij. All-llahu ﷻ i përshkruan ata:

“Ata nuk kundërshtojnë urdhërimet që marrin prej All-llahut, por zbatojnë atë që u është urdhëruar.” (66:6)

All-llahu i ka krijuar ata që ta adhurojnë Atë, dhe vetëm All-llahu ﷻ e di numrin e tyre. Ndër ta janë:

- Xhibrili, i cili është i ngarkuar me dorëzimin e shpalljeve të Dërguarve të All-llahut,
- Mikaili, i cili është i ngarkuar me shiun,
- Engjëlli i vdekjes, që ka për detyrë të mbledhë shpirtrat e njerëzve,
- Bartësit e Fronit të All-llahut ﷻ, dhe
- Rojat e Xhennetit dhe të Xhehennemit.

Përveç këtyre, janë engjëjt që kujdesen pas njerëzve, të tjerë që i shënojnë veprat dhe fjalët e njerëzve, dhe të tjerë të ngarkuar me detyra dhe punë të ndryshme.

Besimi në Librat e Tij

Besimi në Librat e Tij do të thotë të besohet se All-llahu i Madhërishëm u ka shpallur Libra të Dërguarve të Tij që ata t'ua përcjellin popujve të tyre. Këta libra përmbajnë të Folurit e All-llahut ﷻ. Të gjithë këta ishin pa dyshim të patëmetë në çastin e shpalljes tyre, dhe sa herë që shpallej një Libër a Shkrim, ai shfuqizonte paraprijësin e tij. Shkrimet e njohura hyjnore janë:

1. Tora ose Teurati, Libri i All-llahut ﷻ që iu shpall Musës ose Mojsiut, paqja qoftë mbi të.
2. Psalmet, Libri që iu shpall Davudit, paqja qoftë mbi të.
3. Ungjijtë, të shpallur Isait ose Jezuit, paqja qoftë mbi të.

Librat që sot gjenden në duart e të krishterëve dhe hebrenjve, Tora dhe Bibla me Dhiatën e vjetër dhe të renë, nuk janë autentike, ngase ata janë shtrembëruar, ndryshuar dhe janë ngatërruar. Veç kësaj, të gjithë ata janë shfuqizuar nga Libri i fundit i All-llahut, Kur'ani.

Kur'ani është Fjalë e All-llahut ﷻ, Libri i Tij i fundit për njerëzimin, të cilin All-llahu ia shpalli Muhammedit ﷺ, të Dërguarit të fundit për njerëzimin. All-llahu ﷻ e shpalli atë për të bërë çdo gjë të qartë dhe që të jetë mjet udhëzimi dhe mëshire. All-llahu ﷻ ka premtuar se do ta ruajë atë prej çfarëdolloj shtrembërimi, ndryshimi, shtimi a dëmtimi. Ai thotë:

“Vërtet, jemi Ne që e kemi zbritur Përkujtimin (Kur'anin), dhe pa dyshim që Ne do të jemi Ruajtës të tij.” (15:9)

Kur'ani i është zbritur Profetit Muhammed ﷺ pjesë-pjesë, në një periudhë prej njëzet e tre vjetësh. Prej tyre, trembëdhjetë qenë në Mekë, dhe dhjetë në Medinë. Është i ndarë në 114 Kapituj (*Sure*) me gjatësi të ndryshme.

Besimi në të Dërguarit e Tij

Muslimanët dëshmojnë se All-llahu ﷻ i dërgoi Profet çdo popull, me detyrë që t'i thërrasë ata për ta adhuruar vetëm Atë. Ky besim nënkupton, gjithashtu, që të mohohen të gjithë ata zota që adhurohen krahas All-llahut ﷻ ose në vend të Tijin, dhe që gjithë të Dërguarit ishin të ndershëm dhe të singertë dhe që detyrën e tyre e kryen në mënyrën më të mirë. All-llahu ﷻ ka dërguar shumë Profetë, dhe vetëm Ai e di numrin e tyre. Muslimanët janë të detyruar të besojnë

në gjithë të Dërguarit. Ai që mohon ndonjë prej tyre i ka mohuar të gjithë. I Dërguari i parë i All-llahut për njerëzimin qe Nuhu, paqja qoftë mbi të, ndërsa i fundit është Muhammedi ﷺ. All-llahu thotë:

“Dhe me të vërtetë që Ne kemi çuar te çdo popull të Dërguar (duke shpallur) “Adhuroni vetëm All-llahun dhe shmangiuni Tagutit.”¹⁹ (16:36)

Të gjithë të Dërguarit ishin njerëz. All-llahu ﷻ i veçoi ata duke i ngarkuar si Profetë dhe i mbështeti me mrekulli. Ata nuk posedonin cilësi hyjnore dhe as çelësat për të mësuar diç nga bota e së Fshehtës (*Gajb*). Por All-llahu ﷻ dërgoi Muhammedin ﷺ për gjithë njerëzimin, duke thënë:

“Thuaj (O Muhammed): ‘O njerëz! Vërtet që unë jam sjellë te ju të gjithë si i Dërguar i All-llahut...” (7:158)

Nga gjithë të Dërguarit, janë pesë që qenë më të vendosurit dhe më duruesit për të bërë atë çfarë All-llahu ﷻ u kishte urdhëruar. Ata janë: Nuhu, Ibrahim, Musai, Isai dhe Muhammedi ﷺ, i cili është i fundit dhe më i miri nga të gjithë ata dhe krijesa më e mirë ndër njerëz.

Besimi në Ditën e Fundit

Muslimanët e besojnë si të vërtetë çdo gjë që All-llahu ﷻ ose i Dërguari i Tij ﷺ kanë thënë lidhur me vdekjen a me çfarëdo çështje tjetër eskatologjike. All-llahu ﷻ nuk i ka

¹⁹ Tagut është çdo gjë që adhurohet krahas All-llahut ﷻ ose në vend të Tijin.

krijuar krijesat e tij së koti. Por Ai i krijoi njerëzit dhe xhin-
nët që ta adhurojnë Atë dhe u premtoi Parajsën si shpërblim
atyre që respektojnë Atë dhe të Dërguarit e Tij, dhe Skëte-
rrën atyre që nuk i binden Atij ose të Dërguarve të Tij. Ai
ka vendosur një kohë të caktuar për gjithësinë, fundi i së
cilës do të jetë Dita Përfundimtare. Gjatë Ditës së Fundit
njerëzit do të merren në pyetje për veprat e tyre në këtë bo-
të. Dhe ato vepra do të peshohen. Ai veprat e mira të të cilit
do të jenë më të rënda se të këqijat e tij, do të shpëtojë.
Ndërsa në të kundërtën do të futet në Zjarr. Islami është pa-
rakusht që të pranohet një çfarëdo vepër e mirë.

Janë shenjat e vogla dhe të mëdhatë të Çastit Final. Pothuaj-
se të gjitha shenjat e vogla tashmë janë paraqitur. Ato janë
misioni i të Dërguarit Muhammed ﷺ, kalimi i shpejtë i ko-
hës, konkurrenca e barinjve në ndërtimin e pallateve të lar-
ta, konsumimi i madh i pijeve dehëse, marrëdhëniet jashtë-
martesore dhe vese të tjera.

Shenjat e mëdha janë shfaqja e Antikrishtit ose Dexhxha-
lit, një mashtrues që do të deklarohet të jetë zot. Ai do të
përshtojë tërë botën, por nuk do të mundet të hyjë në Me-
kë dhe Medinë. Zbritja e Isait nga qielli është shenjë tjetër
e madhe. Ai do ta vrasë Antikrishtin, do të vrasë derrin
dhe do të bëjë gjëra të tjera. Do të jetojë për një kohë të
caktuar dhe muslimanët do t'ia falin namazin e përmort-
shëm dhe do ta varrosin. E treta është dalja e Jexhuxhëve
dhe Maxhuxhëve (Gogut dhe Magogut), e dy popujve të
mëdhenj që do të bëjnë shkatërrime nëpër tokë, por të cilët
All-llahu në fund do t'i vdesë.

Shenja e madhe e fundit, që do të sinjalizojë se u është af-
ruar fundi të gjitha krijesave, do të jetë lindja e diellit nga

perëndimi. Fryrja e parë në bori do të shënojë fundin. Gjithë krijesat do të ringjallen që të mblidhen për Ditën e Llogarisë duke filluar nga fryrja e dytë në bori. Ajo Ditë do të zgjasë 50 000 vjet, në të cilën njerëzit do të qëndrojnë në këmbë, do të jenë lakuriqë dhe të pabërë synet, si ditën kur janë lindur. Si rrjedhojë, ata do të vuajnë shumë, secili duke u mbytur në djersët e vet, në përputhje me veprat e tij të këqija. Disave djersët do t'u arrijnë gjer te nyajt, disave gjer te gjunjët, disave gjer te beli, disave gjer në gjoks, e disave deri edhe në gojë. Asnjë i Dërguar nuk do të mund t'i ndihmojë popullit të vet. Por, njerëzimi do të kërkojë nga Muhammedi ﷺ që të ndërmjetësojë për ta, pasi të kenë refuzuar të Dërguarit e tjerë të mëdhenj. Ai do të ndërmjetësojë tek All-llahu ﷻ që të fillojë marrja e tyre në pyetje. Dhe All-llahu do ta miratojë ndërmjetësimin e tij.

Pas dhënies së llogarisë, secili do të pranojë regjistrin e vet. Ata që e marrin atë me dorën e djathtë do të jenë të shpëtuar dhe do të hyjnë në Xhennet, ndërkaq ata që e pranojnë me të majtën ose nga prapa shpinës së tyre, do të jenë të shkatërruar. Një urë, më e hollë se qimja dhe më e mprehtë se thika, do të vendoset mbi Xhehennem. Secili duhet të kalojë nëpër atë urë, disa do ta kapërcejnë, ndërsa të tjerët do të bien në Zjarr.

Përshkrimi i Xhennetit

Parajsa, *Xhenneh* në arabishte, është banesë që All-llahu ﷻ ka përgatitur për besimtarët. Në të lumturia është e pasosur dhe në të ka gjëra që syri kurrë s'i ka parë, veshi kurrë s'i ka dëgjuar dhe mendja asnjëherë nuk ka mundur t'i paramendojë. Në të ka vajza të dëlira, lumenj nga qumështi, lumenj nga vera, lumenj mjalti, mish dhe fruta të

shijshme të çfarëdo lloji. Banorët e tij nuk do të përjetojnë lodhje, mërzi a vdekje.

Përshkrimi i Xhehennemit

Skëterra është banesë që All-llahu ﷻ ka përgatitur për të pabesimët që kanë mohuar Atë dhe të Dërguarit e Tij. Ushqimi aty ka hidhësi të padurueshme, pija aty është qelbi që rrjedh nga lëkura e banuesve të tij. Thellësia e tij është e pafund. Jobsimtarët dhe të dyfytirshmit do të rrojnë aty përgjithmonë.

Besimi në Paracaktimin Hyjnor (*Kada' dhe Kader*)

Kada-ja është Paracaktimi i përgjithshëm i All-llahut ﷻ se p.sh. çdo njeri do të vdesë, derisa *Kader-i* është Paracaktimi i posaçëm i All-llahut ﷻ, ose ekzekutimi i *Kada-së*, se çdo person do të vdesë në kohë dhe vend të caktuar. Prandaj, të pranohet ky kusht do të thotë të besohet se All-llahu ﷻ ka krijuar çdo gjë dhe ka paracaktuar masat e duhura.

Aspekte të Kaderit

1. All-llahu ﷻ di shumë mirë çdo gjë që ndodh, dhe Dija e Tij mbulon çdo gjë.
2. All-llahu ﷻ ka shënuar caktimin e çdo gjëje në Pllakat e Ruajtura.
3. Asgjë nuk ndodh në qiej a në tokë pa dëshirën dhe Vullnetin e All-llahut ﷻ. Çkado që All-llahu ﷻ dëshiron ndodh, dhe çfarëdo që Ai nuk do, nuk ndodh.
4. All-llahu ﷻ është Krijuesi i të gjitha gjërave. Nuk ka asnjë krijues tjetër pos Tij.

Rregullat e higjienës

Ligjet islame rregullojnë si jetën personale, ashtu edhe jetën shoqërore të njeriut, për siguruar dëlirësinë e tij dhe pastërtinë e trupit të tij, të rrobave, ushqimit, ambientit, sjelljes, mendimeve dhe qëllimeve të tij.

Rregullat e higjienës në Islam janë të pashoqe kur krahasohen me ato të feve të tjera. Në Islam, higjiena nuk konsiderohet si çështje e zgjedhjes personale. Por, abdesi (*Vudu'*) është vepër e detyrueshme e adhurimit, parakusht për hyrje në namaz. Muslimani duhet të falë së paku pesë namaze obligative çdo ditë, me mendje të dëlirë dhe me pastërti të trupit dhe rrobave të tij. Namazi gjithashtu duhet të kryhet me qëllim të pastër në vend të pastër. Pra, lehtë mund të kuptohen pasojat dhe rezultatet e dobishme që muslimani i fiton me përsëritjen e këtij akti. Është po ashtu e detyrueshme larja pas kontaktit seksual, pas periudhës së menstruacionit dhe në disa raste të tjera.

Veç kësaj, akte të kërkuara të higjienës janë larja e dhëmbëve për të parandaluar prishjen e tyre dhe sëmundjet e ndryshme të mishit të dhëmbëve; prerja e thonjve; shkurtimi i mustaqeve dhe të rruarit e qimeve të sqetullave dhe pjesëve intime. Gjithë kjo dëshmon se Islami nuk merret vetëm me nevojat shpirtërore të njeriut, por edhe me shëndetin e tij trupor.

Gruaja dhe familja në Islam

Islami e ka nderuar gruan duke e ngarkuar atë me edukimin e brezave të ardhshëm. Para Islamit, gruaja trajtohej si objekt shtëpie, pa kurrfarë të drejta, deri aty sa biri më i madh do të trashëgonte gratë e të atit të vet. Në epokën paraislamike vajzat e posalindura varroseshin të gjalla. Edhe kultura të tjera e konsideronin gruan më pak njeri.

Islami jo vetëm që nderon gruan, por e barazon atë me mashkullin nga aspekti i përmbushjeve të obligimeve dhe shpërblimit. All-llahu ﷻ ka bërë devotshmërinë, jo gjininë, kriter të epërsisë. Ai thotë:

“O njerëz! Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë ju në popuj e fise që të njiheni me njëri-tjetrin. Pa dyshim se më i nderuari prej jush tek All-llahu është më i devotshmi ndër ju.” (49:13)

All-llahu ﷻ i mundësoi asaj të ketë pasuri të veten dhe të ketë të drejtë të mbarështojë atë si të dojë vetë, pasi ajo e di se është përgjegjëse para All-llahut ﷻ. Edhe si bashkëshorte ajo kalon mirë, meqë barra për të mbajtur familjen i bie burrit. Ai nuk ka të drejtë të marrë asgjë nga pasuria e saj, nëse ajo vetë me dëshirë nuk i jep atij. Veç kësaj, All-llahu ﷻ u jep prindërve pozitë të lartë, duke i urdhëruar fëmijët të jenë të mirësjellshëm dhe të butë me ta. Ai ﷻ thotë:

“Ndërsa Zoti yt ka përcaktuar që ti të mos adhurosh askënd e asgjë veç Atij dhe që të jesh i përkushtuar ndaj prindërve të tu. Në qoftë se njëri prej tyre ose të dy arrijnë moshën e pleqërisë dhe ti je gjallë me ta, mos u thuaj atyre ‘uf’, e as mos u bë i vrazhdë ndaj tyre, por t’u drejtoheni atyre me shprehje nderuese e me respekt.” (17:23)

All-llahu ﷻ ka urdhëruar që vetëm Ai të adhurohet dhe me këtë urdhër ai ka urdhëruar fëmijët të sillen me mirësi ndaj prindërve. Ky ajet tregon statusin e lartë të prindërve në Islam. Nëna, megjithatë, meriton respekt dhe mirësjellje më të madhe, siç mund të shihet në këtë thënie profetike:

“Një njeri e pyeti të Dërguarin e All-llahut ﷺ: “Kush e meriton shoqërimin tim të mirë më së shumti?” Ai tha: “Nëna jote.” Ky më pas pyeti: “Kush pastaj?” Ai tha: “Nëna jote.” Dhe ky e përsëriti pyetjen edhe dy herë, e i Dërguari ﷺ u përgjigj njësoj, por të kaktërtën herë tha: “Babai yt.”

Rregullat e veshjes për gratë

Në mesin e jomuslimanëve, veshja e femrës është çështje e polemikave të shumta. Diskutimet ngrihen nga shkakut e mosnjohjes së Islamit dhe parimeve të tij. Ata mendojnë se femra muslimane duhet të mbyllet në shtëpinë e saj dhe të mos ketë asnjëfarë të drejte. Ata e shikojnë muslimanën nga këndvështrimi historik i kulturës së tyre, në të cilën gruaja është kryengritur kundër kufizimeve të saj dhe është liruar nga prangat e së kaluarës. Ky është një men-

dim etnocentrik i gruas jomuslimane. Ngase gruaja perëndimore as në të kaluarën e as tash nuk ka përjetuar ndjenjen e vërtetë të lirisë.

Që nga kohët e lashta, nëpër Mesjetë, Rilindje dhe gjatë Revolucionit Industrial e deri në kohën e sotme të teknologjisë, ato kanë kaluar prej një forme të skllavërisë në formën tjetër, me vetë dëshirën e tyre, duke menduar se faza e fundit paraqet liri përfundimtare, ndërsa ajo nuk është asgjë përveçse skllavëri në maskë të re. Ato dolën nga shtëpitë e tyre për të kërkuar nga meshkujt të drejtat e tyre, barazinë, pa përfillur faktin se ndërtimi i tyre fizik ka kufizime të caktuara dhe se atyre u janë dhuruar funksione të posaçme për qëllime të caktuara. Rezultatet mund të shihen shumë qartë në shkatërrimin e familjes perëndimore.

Veshja e mbulesës islame nga gruaja muslimane nuk është zakon kulturor, i trashëguar nga ndonjë kulturë a qytetërim më i vjetër. Por, është institucion i urdhëruar prej Atij që krijoi njerëzimin. Nga urtësia e Tij e pakufishme, Ai e bëri detyrim për gruan.

Edhe burri edhe gruaja janë krijuar me dëshira seksuale. All-llahu ﷻ ka vënë rregulla dhe masa parandaluese që do të kontrollojnë këto epshe dhe do t'i mbronin të dy gjinitë kundër çfarëdo forme të marrëdhënieve të palejueshme, dhe gjithë kjo për të ruajtur brezat e ardhshëm dhe që raportet ndërmjet burrit dhe gruas të jenë korrekte. Ndjekja e këtyre rregullave dhe masave të kujdesit do të çojnë pa-tjetër deri te zhvillimi i një familjeje të shëndoshë dhe të një shoqërie të shëndoshë.

Përfundim

Islami është feja që All-llahu zgjodhi për njerëzimin. Ai ka thënë:

“Pa dyshim se feja (e vërtetë dhe e pranuar) tek All-llahu është Islami.” (3:19)

Që do të thotë se porosia është universale. Për këtë arsye, njeriu nuk ka nevojë të zhvillojë a të formulojë ligje të reja që do t'i përshtateshin çdo kohe dhe çdo stili jete. Islami është mënyrë jete që vepron në çdo sferë të jetës së njeriut, si sociale, ekonomike, politike, etj. Islami ka zgjidhje për çdo problem, çfarëdo natyre a peshe qoftë. Është mesazh hyjnor për përcjelljen e të cilit All-llahu ﷻ zgjodhi Muhammedin ﷺ. Njeriut Ai gjithashtu i shpalli Kur'anin, Librin e Tij të fundit, që ka përmbajtje të pandryshueshme. Tash, pasi lexuat këtë libërth dhe u njohët për së afërmi me parimet themelore të Islamit, vendimi mbetet te ju. Të gjithë ju jeni udhëtarë drejt të njëjtit fund, por rruga të cilën zgjedhim përcakton destinimin tonë në Përjetësi.

All-llahu ﷻ është aq i Madhërishëm dhe i Drejtë, saqë thotë:

“Dhe Ne nuk ndëshkojmë derisa të çojmë një të Dërguar (për të udhëzuar e këshilluar).” (17:15)

Nga dëshira që edhe ju të mësoni këtë porosi, përgatitëm këtë libërth për ju.

“Ky është Libri (Kur’ani), mbi të cilin nuk ka asnjë dyshim, udhëheqje për El-Mutte-kun (që janë njerëz të përkushtuar dhe besimtarë të drejtë që i frikësohen All-llahut shumë, duke u larguar nga të gjitha llojet e gjynaheve dhe veprave të cilat Ai i ka ndaluar, dhe të cilët e duan shumë All-llahun, duke zbatuar të gjitha llojet e punëve të mira që Ai i ka urdhëruar).” (2:2)

“All-llahu e ka zgjedhur për ju fenë e vërtetë, kështu që mos vdisni ndryshe përveçse në besimin islam (si muslimanë).” (2:132)

“Dhe kushdo që kërkon ndonjë fe tjetër përveç Islamit, ajo kurrë nuk do t’i pranohet atij dhe në Botën e Pastajme do të jetë prej të humburve.” (3:85)

“Këtë ditë Unë e përsosa fenë tuaj për ju, plotësova Mirësinë Time mbi ju dhe zgjodha për ju Islamin si fe.” (5:3)

“Sigurisht, ata të cilët nuk besojnë All-llahun dhe të Dërguarit e Tij dhe që duan të bëjnë dallime mes besimit në All-llahun dhe në të Dërguarit e Tij (duke besuar All-llahun dhe duke mos i besuar të Dërguarit) duke thënë: “Ne besojmë në disa prej tyre,

por i mohojmë të tjerët” dhe që duan të bëjnë për vete një rrugë të ndërmjetme.” (4:150)

“Është Ai që ka sjellë të Dërguarin e Tij (Muhammed ﷺ) me udhëzim dhe me fenë e së vërtetës (Islamin) për ta nxjerrë atë përmbi të gjitha fetë, edhe pse *mushrikët* (politeistët, mohuesit e Njëjesisë së All-llahut) e urrejnë (këtë).” (9:33)

“A është ai të cilit All-llahu ia ka hapur gjoksin në Islam duke qenë në dritë prej Zotit të tij (si ai që nuk është musliman)? Mjerë për ata pra, zemrat e të cilëve janë ngurtësuar ndaj përkujtimit të All-llahut! Ata janë në gabim e humbje të qartë.” (39:22)

“O njerëz! Adhuroni All-llahun, Zotin tuaj, i Cili ju krijoi ju dhe ata që qenë para jush, që të mund të bëheni të përkushtuar (*El-Mut-tekun*).” (2:21)

“I Cili e ka bërë tokën vend pushimi për ju, dhe qiellin me kupe si mbulesë duke dërguar që andej ujë për të prodhuar fruta si furznizim për ju. Atëherë pra, mos i vini shokë All-llahut (në adhurim) kur ju e dini (se vetëm Ai ka të drejtë të adhurohet e askush tjetër).” (2:22)

Disa hadithe (thënie profetike) për Islamin

Tregon Abdullah bin Amri, All-llahu qoftë i kënaqur me të: Një njeri pyeti të Dërguarin ﷺ: “Cilat janë cilësi të mira të Islamit?” I Dërguari ﷺ u përgjigj: “T’i ushqesh të tjerët dhe t’i përshëndetësh ata që i njeh dhe ata që nuk i njeh.” (*Buhariu, Hadithi nr. 11*)

Tregon Ebu Seid el-Khudri, All-llahu qoftë i kënaqur me të: I Dërguari i All-llahut ﷺ ka thënë: “Nëse një person pranon Islamin sinqerisht, atëherë All-llahu do t’ia falë të gjitha mëkatet e mëparshme, dhe që këtej do të nisë llogaritja e veprave: shpërblimi për veprat e tij do të jetë dhjetë deri në shtatëqind herë për secilën vepër të mirë, ndërsa vepra e keqe do të shënohet si e tillë, ose All-llahu do ta falë të tërën.” (*Buhariu, Hadithi nr. 39*)

Rrëfen Ebu Hurejre, All-llahu qoftë i kënaqur me të: I Dërguari i All-llahut ﷺ ka thënë: “Çdo fëmijë lind në *Fitreh* (besim i vërtetë i monoteizmit islam), por prindërit e tij e kthejnë atë në çifut, të krishterë ose në zjarrputist, ashtu si kafsha që lind të voglin në formë të përsosur. A e gjeni atë të gjymtë?” Pastaj Ebu Hurejre lexoi ajetet: “*Fitre*-ja e All-llahut me të cilin Ai ka krijuar njerëzimin. Le të mos ketë asnjë ndryshim në *Khalkil-lah* (në Fenë e All-llahut, në Besimin e Pastër Islam).” (*Buhariu, Hadithi nr. 1359*)

Rrëfen Ebu Hurerje, All-llahu qoftë i kënaqur me të: “I Dërguari i All-llahut ﷺ ka thënë: “Të gjithë pasuesit e mi do të hyjnë në Parajsë, përveç atyre që refuzojnë.” Ata thanë: “O i Dërguar i All-llahut!

Kush do të refuzojë?” Ai tha: “Kushdo që më bindet mua do të hyjë në Parajsë, dhe kushdo që nuk më respekton mua është prej atyre që refuzojnë.” (*Buhariu, Hadithi nr. 7280*)

Profeci biblike për ardhjen e Muhammedit

Gjoni 14: 15-16

“Nëse më doni, do t’i mbani urdhërimet e mia. Edhe unë do t’i lutem Atit dhe Ai do t’ju japë një Mbrojtës tjetër, që të jetë me ju përgjithmonë.”

Gjoni 15: 26-27

“E kur të vijë Mbrojtësi, të cilin do t’ju dërgoj prej Atit – Shpirti i së Vërtetës, që rrjedh prej Atit – Ai do të dëshmojë për mua. Por edhe ju gjithashtu do të dëshmoni për mua, sepse jeni me mua që në fillim.”

Gjoni 16: 5-8

“Por tani po shkoj tek Ati, që më dërgoi, dhe askush prej jush s’po më pyet: ‘Nga po shkon?’, por, pse ju thashë këto, zemrat tuaja u mbushën me trishtim. Por, unë po ju them të vërtetën: është më mirë për ju të shkoj, po s’shkova, Mbrojtësi nuk do të vijë tek ju, kurse, po shkova, do ta dërgoj tek ju. E kur të vijë Ai, do të vërtetojë se bota është gabim në lidhje me mëkat, me padrejtësi dhe me dënim.”

Gjoni 16: 12-14

Kam edhe shumë gjëra të tjera për t’ju thënë, por tani s’mund t’i kuptoni. E kur të vijë ai – Shpirti i së Vërtetës – Ai do t’ju udhëzojë ta njihni tërë të Vërtetën. Ai s’do të flasë prej vetvetes, por do të fla-

së çka të dëgjojë dhe do t'ju zbulojë të ardhmen. Ai do të më lëvdojë, sepse do të marrë prej simes e do t'ju zbulojë juve.”

Gjoni 16: 16

“Edhe pak kohë e nuk do të më shihni, prapë edhe pak e do të më shihni.”

[Teologë muslimanë kanë deklaruar se personi për të cilin Jezui thotë se do të vijë pas tij – në versetet e sipërcekura – nuk është askush tjetër përveçse Muhammedi ﷺ, i Dërguari i All-llahut. Ky ‘person’ për të cilin Jezui profetizoi, në Bibël quhet ‘Paraklita’. Kjo fjalë është shlyer nga komentatorët dhe përkthyesit e mëvonshëm, dhe herë është ndërruar në ‘Shpirti i së Vërtetës’, e herë në ‘Ngu-shëlluesi’, e ndonjë herë tjetër në ‘Shpirti i Shenjtë.’ Fjala origjinale është në greqishte dhe ka kuptimin ‘ai të cilin njerëzit e lëvdojnë shumë’. Ky kuptim i përgjigjet fjalës ‘Muhammed’ (në arabishte).]

Mahmud R. Murad

Islami – me pak fjalë

Recensues:
Sabri Jonuzi

Redaktor gjuhësor:
Arlind Boshnjaku

Faqosja dhe kopertina:
Arsim Murseli

Copyright ©:
"Gjurma"

Boton:
Gjurma – Shoqatë për veprimtari kulturore - Prishtinë

Adresa:
Dardania-Kurrizi; Blloku 9, Lokali 15
Tel. 038/551 154

Kjo porosi është për çdo njeri të hapur dhe mendjegjerë. Është për çdo kërkimtar të së vërtetës që ndoshta ndonjëherë ka pyetur veten se çfarë është feja islame, kush është Zoti (All-llahu), cili është qëllimi përfundimtar i ekzistencës së njeriut. Këto pyetje dhe shumë të tjera shtrohen për t'u shqyrtuar në raste të ndryshme, por më vonë ato prapësohen dhe lihen në mes për lloj-lloj arsye. Kjo broshurë nuk mëton të përgjigjet në të gjitha pyetjet për të cilat ju do të dëshironit përgjigje. Megjithatë, do të hapë për ju një dimension të ri të të menduarit dhe do t'ju mundësojë që të kuptoni rëndësinë e rolit tuaj si njeri në këtë gjithësi dhe raportin ndërmjet juve dhe Krijuesit tuaj, Zotit, All-llahut të Plotfuqishëm.

